

Sinjalizime

Ekskluzive | Sulmi me granatë në Podujevë, bastisen shtëpitë e të dyshuarve – gjenden armë e municion, dy persona në kërkim



Sinjali.com

22 Korrik 2026 08:59



Katër muaj pas sulmit me granatë ndaj një shtëpie në fshatin Sfeqël të Podujevës, Policia e Kosovës ka zhvilluar një aksion të gjerë, duke bastisur shtëpitë e personave të dyshuar dhe duke sekuestruar armë, municion e pajisje të ndryshme ushtarake, raporton Sinjali.

Sinjali mëson ekskluzivisht se të dyshuarit në këtë rast janë L. Z.-P. rreth 37 vjeç, L.L. rreth 36 vjeç dhe A.Z. rreth 26-vjeç, ndërsa viktimë e rastit është D. Sh.rreth 24 vjeç.

Sipas burimeve të Sinjalit, ngjarja kishte ndodhur më 11 mars 2026, kur ndaj shtëpisë së familjes Shaqiri në fshatin Sfeqël ishte hedhur një mjet shpërthyes që dyshohej të ishte granatë dore. Fillimisht rasti ishte iniciuar si *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”*, por pas veprimeve hetimore dhe grumbullimit të provave, në koordinim me Prokurorin e Shtetit, është ricilësuar si *“Vrasje në tentativë”*, *“Shtytje”* dhe *“Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*.

Më 21 korrik, me urdhër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, hetuesit e Njësisë për Hetimin e Krimeve të Rënda, të asistuar nga Njësia Speciale Operative dhe njësia K9, kanë realizuar bastisje në dy lokacione në Podujevë.

Gjatë kontrollit në shtëpinë e L. Z.-P., Policia ka sekuestruar dy pistoleta (njëra e dyshuar armë me gaz), 67 fishekë të kalibrave të ndryshëm, tre karikatorë për pistoleta, tre karikatorë për armë të gjata, një gëzhojë dhe pjesë të ndryshme armësh të gjata.

Ndërkohë, në shtëpinë e L.L. është gjetur dhe sekuestruar një pistoletë, ndërsa ndaj tij është iniciuar një rast i veçantë për veprën penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*.

A.Z. është intervistuar në lidhje me posedimin e paautorizuar të armëve dhe, me urdhër të Prokurorit, është liruar në procedurë të rregullt.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se Lavdim Zejnullahu-Parascan dhe L.L. nuk janë gjetur në adresat e tyre gjatë aksionit. Të njëjtëve u janë lënë ftesa për paraqitje në Polici, ndërsa janë shpallur në kërkim policor.

Hetimet për rastin vazhdojnë.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Podujevë

bastisje

Armë

Të tjera:



Ekskluzive | Këta janë të dyshuarit për sulmin me granatë në Podujevë – Policia bastis shtëpitë,...

Sinjalizime




Ekskluzive | Skenë si në filma në Podujevë: Hajnat thyejnë fabrikën “AMG” gjatë natës,...

Sinjalizime



“Dënim maksimal”, mbahet marshi për Lulzim Fejzullahun në Podujevë

Sociale



Kurti: Vrasja mizore e Lulzim Fejzullahut duhet të jetë alarm për të gjithë, përfshirë...

Sociale



Rasti tragjik në Podujevë, Kurti shkon për kryeshëndosh te familja e 18-vjeçarit që...

Sociale



“Vrasja ka ndodhur një ditë pas zënkës në lokal”, flet berberi ku dyshohet se nisi konfli...

Siguri



Sot i jepet lamtumira e fundit 19-vjeçarit që vdiq tragjikisht në kufirin Serbi-Kroaci

Sociale



Sot i jepet lamtumira e fundit të riut që vdiq mbrëmë në aksidentin e rëndë në Podujevë

Sociale

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera